

LIGJ
Nr.10 427, datë 2.6.2011

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË FEDERATËS RUSE PËR
PËRMBUSHJEN E DETYRIMEVE FINANCIARE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
KUNDREJT FEDERATËS RUSE PËR BALANCAT E LLOGARIVE TË KORPORATËS
SHTETËRORE “BANKA E ZHVILLIMIT DHE VEPRIMTARISË EKONOMIKE ME
JASHTË (VNESHEKONOMBANK)” TE BANKA E SHTETIT SHQIPTAR”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Federatës Ruse për përmbushjen e detyrimeve financiare të Republikës së Shqipërisë kundrejt Federatës Ruse për balancat e llogarive të korporatës shtetërore “Banka e Zhvillimit dhe Veprimtarisë Ekonomike me Jashtë (Vneshekonombank)” te Banka e Shtetit Shqiptar”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.7016, datë 13.6.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

MARRËVESHJE

**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË FEDERATËS RUSE PËR PËRMBUSHJEN E DETYRIMEVE FINANCIARE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË KUNDREJT FEDERATËS RUSE MBI BALANCAT E
LLOGARIVE TË KORPORATËS SHTETËRORE “BANKA E ZHVILLIMIT DHE
VEPRIMTARISË EKONOMIKE ME JASHTË (VNESHEKONOMBANK)” TE BANKA E
SHTETIT SHQIPTAR**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Federatës Ruse (këtu quhen “palë”), me qëllim forcimin e bashkëpunimit dypalësh dhe të marrëdhënieve miqësore ndërmjet të dy vendeve, kanë rënë dakord sa më poshtë:

Neni 1

1. Dispozitat e kësaj marrëveshjeje zbatohen për detyrimet financiare të Republikës së Shqipërisë ndaj Federatës Ruse që përfaqëson balancën e përgjithshme të pashlyer në llogaritë e veçanta nr.5, 6A dhe 6B të korporatës shtetërore “Banka e Zhvillimit dhe Veprimtarisë Ekonomike me Jashtë (Vneshekonombank)” (më tutje Vnesheconombank), të hapur në Bankën e Shtetit të Shqipërisë për t’i shërbyer xhiros tregtare dhe operacioneve jotregtare ndërmjet BRSS-së dhe Republikës Popullore të Shqipërisë.

2. Detyrimet e sipërpërmendura janë 1036723,48 rubla sovjetike (këtu quhet “borxhi”). Borxhi konvertohet në dollarë amerikanë me një normë këmbimi prej 1 USD-1 rubël sovjetike. Pas zbatimit të normës së këmbimit të sipërpërmendur, borxhi është 1036723,48 USD.

Neni 2

1. Borxhi do të shlyhet tërësisht nga pala shqiptare në dollarë amerikanë në favor të palës ruse jo më vonë se 30 qershor 2011.

2. Pas pagesës së borxhit sipas këtij neni, detyrimet financiare të palës shqiptare të përmendura në pikën 1 të nenit 1 të kësaj marrëveshjeje konsiderohen tërësisht të përmbushura.

Neni 3

1. Nëse borxhi nuk shlyhet tërësisht deri më 30 qershor 2011, pjesa e mbetur e kësaj shume konsiderohet të jetë në vonesë dhe do të mbartë një interes me normën e Liborit duke shtuar një marzh prej 4 (katër) për qind (këtu quhet “interesi i vonuar”). Interesi i vonuar mbledhet duke filluar nga 1 korrik 2011 deri në datën e shlyerjes së plotë dhe duke përfshirë pjesët në vonesë dhe do të paguhet në dollarë amerikanë.

2. Interesi i vonuar llogaritet mbi bazën e numrit faktik të ditëve që kanë kaluar në një vit 360-ditor.

Neni 4

1. Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë dhe Vnesheconombank janë agjentët e autorizuar të palëve shqiptare dhe ruse përkatësisht për qëllimet e llogaritjeve sipas kësaj marrëveshjeje.

2. Agjentët e autorizuar, jo më vonë se 30 ditë nga data e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, bien dakord me shkrim për termat dhe kushtet teknike të llogaritjes sipas kësaj marrëveshjeje.

Neni 5

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në datën e njoftimit të fundit me shkrim nga secila palë, që konfirmon përfundimin e procedurave përkatëse të brendshme shtetërore.

Kjo marrëveshje mbetet e vlefshme derisa palët të kenë përmbushur detyrimet e tyre sipas kësaj marrëveshjeje.

Bërë në Moskë më 31 mars 2011, në dy kopje origjinale, secila në shqip dhe rusisht, ku të dyja tekstet janë njëlloj autentike.